

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ZYRA E KRYEMINISTRIT

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr. i Prokurimit ¹	ZK 104 24 022 221
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: SHERBIME TE SHTYPJES DHE BOTIMIT

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Emri i Kompanisë: EUROPRINT GROUP SHPK

Adresa: Prishtine ,10 000

Numri Telefonit: 049/589845

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: ARBENOR ZABELI

Adresa elektronike: EUROPRINTGROUP@GMAIL.COM

Data e parashtrimit të ankesës: 14.06.2024



Nënshkrimi dhe vula:

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë është bërë me datë : 01.05.2024

Kriteret e Dhënies : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët

Hapja e tenderit është me datë : 23.05.2024 ora 14:00

Njoftim mbi vendimin e AK-se : 05.06.2024

Kerkesen për rishqyrtim me datë : 07.06.2024

Pergjigja e kërkesës për rishqyrtim nga AK : 10.06.2024

Ankesa në OSHP : 14.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input checked="" type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------	--

Hapja është bërë në mënyrë elektronike e ofertave është bërë me datën 23.05.2024 -

Nuk kemi marrë pjesë në hapje të ofertave.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input checked="" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Me datën 05.06.2024 përmes Platformës së E-prokurimit kemi pranuar formularin B58-Vendimin e AK. Ne kemi pranuar Letrën Standarde B46 për Tenderuesin e Eliminuar.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po	<input checked="" type="checkbox"/>	Jo	<input type="checkbox"/>
----	-------------------------------------	----	--------------------------

Përmes Kërkesës për Rishqyrtim të datës 07.06.2024 OE EUROPRINT GROUP SHPK ka paraqitur dëshmitë dhe faktet Autoritetit Kontraktues- **ZYRA E KRYEMINISTRIT** se për këtë aktivitet ka bërë gabim në vlerësimin e situatës dhe eliminimin e ofrës të tona në mënyrë të gabuar diskriminuese dhe të pa drejtë si dhe i pa bazuar dhe në kundërshtim të plotë me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe ligjet tjera në fuqi, por me datën 10.06.2024 AK – **ZYRA E KRYEMINISTRIT** e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë: Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 1 Qellimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Shkeljet e dispozitave - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik 001/2023

Neni 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Më datën **05.06.2024**, Autoriteti Kontraktues (AK) – **ZYRA E KRYEMINISTRIT** në Platformën e E-Prokurimit ka bërë publikimin e Formularit - **B58 - Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues-për dhënie të kontratës, ku me kontratë ka shpërblyer një OE të caktuar**

Në arsyetimin për eliminimin të **Operatorit Ekonomik EUROPRINT GROUP SHPK**, shihet shumëqartë se Autoriteti Kontraktues- **ZYRA E KRYEMINISTRIT, zyra e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit** nuk kanë vepruar konform ligjit të LPP-se duke na eliminuar pa drejtesisht nga ky aktivitet i prokurimit pasi që arsyetimi për eliminim të kompanisë sone është shumë i ulët dhe nuk qëndron ajo arsye e eliminimit.

Me këtë veprim komisioni vlerësues së bashku me zyrën e prokurimit nuk e kanë respektuar ligjin e prokurimit pasi që nuk kanë kërkuar fare sqarime por menjherë na kanë eliminuar. Nuk është respektuar Udhëzuesi Nr.001/2023 për prokurim publik ku AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-se, ku çeket shumë mirë se mund të kërkojnë sqarime.

Autoriteti Kontraktues **ZYRA E KRYEMINISTRIT** ka bërë shkelje të **Nenit 60 të LPP-së**, pasi që nuk na ka shpallur fitues në si OE me çmimin më të ulët dhe i përgjegjshëm ashtu siq është çekur në Dosjen e tenderit :

IV.6 KRITERET PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Kontrata do t'i ipet operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

Tenderin e përgjegjshëm, me çmimin më të ulët

AK-ja ketu ka bere shkelje ligjore duke vendosur te ipet kontrata OE me te shtrejt per 8,500.00 euro keshtu duke keqperdore paran publike dhe fondet publike.

Gjithashtu eshe shkelur Neni 1 Qellimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla

Ku AK **ZYRA E KRYEMINISTRIT e ka shkelur ligjin primar Neni 1 te LPP-se pasi nuk jane treguar transparent dhe efikas dhe duke shfrytezuar fondet publike ne menyre te gabuar pasi qe e kane shpallur fitues nje OE me te shtrejt se oferta jone per 8,500.00 euro**

Neni 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP dhe në bazë të arsyes për eliminimin e ofertës të cilës vërehet qartë se nuk është bërë vlerësimi sipas kritereve.

Nëse si OE kemi dorëzuar listën e kontratave të përfunduara dhe vërehet qartë se nuk e kanë shikuar listën dhe nuk kanë kërkuar sqarime shtesë. Sipas AK ZYRA E KRYEMINISTRIT thuhet se ne si OE kemi deklaruar se kemi kontratë në vlerë vetëm 54,492.06 euro, ku kompania jone vetëm një kontratë me Ministrinë e Punëve të Brendshme e kemi 250,800.00 euro dhe me këtë e mbulojmë kërkesën e AK që duhet të ketë kontratë në vlerë prej 80,000.00 euro.

Gjithashtu na janë listuar listën e kontratave të cilat kanë qenë me shtyp por që Zyra e Prokurimit në ZKM nuk e ka marrë përsipër dhe e ka refuzuar menjëherë.

Nuk është gabimi i joni nëse një institucion i caktuar nuk e bën procedurën shërbime ose të ceket në procedurë emri shërbime të shtypjes. Dhe ne nuk e kemi ndryshuar titullin dhe e kemi lënë siç ka qenë në kontratë. Pasi që kontratë që janë të perizera - furnizime edhe shërbime.

1.Kontrata me MPB në vlerë prej 250,800.00 euro ka pas të bëjë me shtyp pasi ne si OE e kemi fituar kontratën për të shtypur stikerat, stikerat të cilat i janë vendosur makinave në hyrje të kufirit të Republikës së Kosovës – kanë qenë ata stierat të cilat i janë vendosur makinave me tabela të serbise. Nuk është faj i joni nëse AK MPB e ka vendosur titullin furnizim emergjent me letër ngjithëse-afishe të plastifikuara për targat e aluminit dhe nuk është e drejtë nëse ne e ndryshojna titullin. Por dihet mjaft qartë se në këtë kontratë është bërë shtypja sipas kërkesës së AK-se në leterngjithëset të cilat janë vendosur në tabela të automjeteve. Kontratë e cila shumë lehtë mund të vërtetohet edhe përmes MPB-se.

2.Gjithashtu ne kemi bërë edhe shtypjen e rollneve fiskale (rollne boarding pass) për Limak Kosovo International Airport – në vlerë prej 9,357.00 euro jau bashkanejgesim edhe rollnen të cilën e kemi shtypur.

3.Kontrata me Komunen e Shtimes ku e kemi bashkanegjitur specifikacionin ku shihet qarte qe ka pas shtyp ne specifikacion ku ne si OE kemi bere shtypjen e Dosjeve,Notesave,Pliko, letër rollne, fasiklla kartoni,kopertina plishi, mirenjohje , blloka udhëtimi, blloka participimi, blloka per inkasim, blloka urdhër dalje depos, certifikata mjekesore, flete kerkes per barna, flete kerkes per barna dhe maerial mjekesore , regjister i perdoresuve te narkotivece dhe substanca psikotripe , procesverbal per raport te aksidenteve , raport per pa aftesi te perkohshme nga puna , regjister i pacienteve per vizita shtepiakve e shume artikuj te tjer ku te gjithë kane qene shtyp me llogo te instutcionit, vlere totale vetem shtyp eshte 9,463.00 euro jau bashkanegjesim edhe specifikacionin.

4.Kompania e Ujesjellesit Rajonal Mitrovica vlere e kontrates 10,555.02 euro ku ne si kompani kemi bere shtypjen e artikujve – bllok depoje te hyrjes , bllok depoje fletedalje , bllok urdher arke , bllok deftese pagese A6 , bllok urdher pagese , bllok ditare arke A4 , bllok ditar urdher arke , bllok per montmin e oreve , bllok kerkes per material a5 ,bllok urdherese te automjeteve , liberr lidhese i faturave , urdheres pune A4 ,procesverbal me tri kopje ,liber per protokoll , liber inter, liber per meditje, liber lidhese e shume e shume artikuj tjer te cilat i kemi shtypur me llogo.

5.Bashkesia Islame e Kosoves – shtypja e vaktise se ramazanit vlere 2,800.00 euro

6.Furnizim me medalje dhe rekuizita vlere e kontrates 4,471.49 ku ne i kemi bere shtypjen ne medalje dhe rekuzitia sipas kerkese se AK – Inspektoriati Policore i Kosoves ‘

7.Posta e Kosoves Sh.A – Furnizim me vula datare per nevojat e zyrove postare vlere e kontrates 5,924.19 – ku ne i kemi bere furnizimin dhe shtypjen e vulave sipas kerkeses se AK-se.

8.Zyre Administrative – MFPT ku ne kemi bere shtypje ne Fasikllave A4 me llogo MFPT , Stilolapes me llogo , fletrore B me llogo , zarf me flet kthes dizajni miret nga AK, e shume artikuj tjer me llogo vlere totale vetem per shtyp eshte 3,255.00 euro jau bashkanegjesim edhe specifikacionin

9.Agjencia qendrore e prokurimit –ku ne kemi bere shtypjen e Zarfave me llogo , leter per certifikata , fletore pune me spirale e shume artikuj te tjere vlere e tyre eshte 3034.00 euro

10.Spitali i pergjithshem Dr.Sami Haxhibesiqi vlere e kontrates 36,000.00 euro ku kemi bere shtypjen e dokumenteve mjekesore sipas kerkese se AK-se.

GJITHASHTU KERKESA E AK KA QENE ME PAS SHERBIME TE NGJAJSHME DHE SIC SHIHET TE GJITHA KETO DUHET TE SHTYPEN NE LETER A4 ANDAJ SI REFERENC DUHET TE MIRREN EDHE LETRAT. ANDAJ KERKOJME NGA EKSPERTI DHE PANELI I OSHP QE FURNIZIMET ME LETRA TE MIRREN EDHE SI KONTRATA TE NGJAJSHME PASI QE PROJEKTI NE FJAL TE GJITHA PRODUKTET DO TE SHTYPEN NE LETRA

REFERENCAT TE CILAT I KA PRANUAR AK – ZYRA E KRYEMINISTRIT KANE VLEREN E 54,492.06 EURO , KUR JA SHTOJME KESAJ VLERE EDHE 9,357.00 EURO VLEREN E SHTYPJES SE ROLLNEVE ME LLOGO ; 5,924.19 VLEREN E KONTRATES SE POSTA E KOSOVES KU KEMI BERE SHTYPJEN E VULAVE ; SHTYPJEN E DOKUMENTAVE SIPAS KERKES SE MFPT VLERA 3255 EURO ; SHTYPJEN E DOKUMENTAVE TE NDRYSHEM PER KK SHTIMEN 9,463.00 EURO ; KONTRATEN ME AQP VLERA 3034.00EURO ; KONTRATEN ME MPB 250,800.00 EURO ; SI DHE KONTRATA TJERA ATEHER TEJKALOHET SHUMEHER VLERE E

KERKUAR NGA AK ZYRA E KRYEMINISTRIT.

GJITHASHTU NE DO TE JAU BASHKANEGJESIM KONTRATAT TE CILAT I KEMI LISTUAR SE BASHKU ME FATURAT DHE SPECIFIKACIONIN TEKNIK SE MUND TE VEREHET QARTE QE NE SI KOMPANI E TEJKALLOJME VLEREN PREJ 80,000.00 EURO.

Bazuar në të gjitha këto të dhëna të shënuara me lartë dhe dëshmitë e bashkangjitura kërkojmë nga Eksperti i OSHP-se si dhe nga Paneli i OSHP-se ,që ankesen tone të merrë si të bazuar dhe të faktuar , dhe lëndën të kthejë në RI-VLERËSIM dhe te shpallemi ne si fitues te keti projekti.

9. Dëmet materiale

Përshtetja mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

- Vleresimi i gabuar i AK-se per vleresimin e kesaj procedures na krijon kosto dhe marzhe te fitimit te humbur demtim fitimit eventual marzhes dhe imazhit duke na krijuar diskriminim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

Njoftimi per kontrate eshte bere me date : 01.05.2024

Kriteret e Dhënies : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët

Hapja e tenderit eshte me date : 23.05.2024 ora 14:00

Njoftim mbi vendimin e AK-se : 05.06.2024

Kerkesen per rishqyrtim me date : 07.06.2024

Pergjigja e kerkeses per rishqyrtim nga AK : 10.06.2024

Ankesa ne OSHP : 14.06.2024

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*